



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-112

Prishtinë, më 3 qershor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 QERSHOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe të pranishmit i njoftoi me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 maj 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 maj 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 maj 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 31 maj 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 6 qershor 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Votimi i Rezolutës lidhur me të drejtat elementare të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.*

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet më 6 qershor 2013, në orën 10:15, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për blegtorinë,*

7. Propozimi për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
8. Propozimi për zgjedhjen e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2012,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës për vitin 2012,
13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012,
14. Debat parlamentar lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009-2015,
15. Debat parlamentar lidhur me rirregullimin (heqjen) e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2013, sipas pasqyrave të paraqitura në këtë raport.

2. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, vendosi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e radhës, me qëllim të konsultimeve shtesë ndërmjet deputetëve të Grupit Parlamentar të SLS-së dhe të Grupit Parlamentar “ZB”.

3. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për Komisionin e Integrimeve Evropiane të Kuvendit të Maqedonisë që e ka vizituar Kuvendin e Kosovës, prej 22-23 maj 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe të përkthimit për anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian të Kuvendit të Maqedonisë, që e kanë vizituar Kuvendin e Kosovës më 22-23 maj 2013.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Holandë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i delegacionit të Grupit të Grave Deputete, në këtë përbërje: Teuta Sahatqija, Flora Brovina, Donika Kadaj-Bujupi, Alma Lama, Sevdije Lama, Mufera Shinik, Jelena Bontiq, si dhe nga stafi politik mbështetës i Administratës së Kuvendit, Arjeta Rexhepi, për vizitën studimore në Parlamentin e Holandës, prej datës 24-27 qershor 2013.

2. Shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit për të lartshënuarat në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Ambasada e Holandës në Prishtinë, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

5. Kërkesë për mbështetje financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I rekomandohet Ministrisë së Shëndetësisë që t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për shërim jashtë vendit për z. Veton Demaj.

6. Njoftim lidhur me listën e anëtarëve të Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Arabisë Saudite me Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me çështjen e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që, mbi bazën e propozimit të nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, për formimin e dhjetë (10) grupeve të miqësisë, t'i propozojnë deputetët për anëtarë për secilin Grup të Miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e shteteve të tjera.

2. Propozimet, sipas pikës një (1) të këtij përfundimi, të procedohen për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

Pika shtesë:

1. Kërkesë për lejimin e udhëtimit deputetëve në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetët e Kuvendit: Lutfi Haziri, Adem Grabovci, Ganimete Musliu, Blerta Deliu-Kodra dhe Albert Kinolli mund të marrin pjesë në Lutjet e Mëngjesit në Gjermani prej 5-9 qershor 2013, me mjete financiare nga buxheti i grupeve parlamentare.

2. Mëditjet shtesë (30 %) për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale